



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 8 korrik 2014
Nr.ref.:AGJ679/14

AKTGJYKIM

në

Rastet Nr. KI99/14 dhe KI100/14

Parashtrues

Shyqyri Syla dhe Laura Pula

Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me procedurën e zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë z. Shyqyri Syla (KI99/14), Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, dhe znj. Laura Pula (KI100/14), Prokurore në Zyrën e Prokurorit të Shtetit (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

Parashtruesit e kërkesës ishin kandidatë në procedurën e zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë procedurën e zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit. Parashtruesi z. Shyqyri Syla, KI99/14, konteston Vendimin KPK nr. 151/2014 të Këshillit Prokurorial të Kosovës, të 6 qershorit 2014, për emërimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit. Në anën tjetër, parashtruesja e kërkesës, znj. Laura Pula, KI100/14, konteston Vendimin KPK/146/2014, të 5 qershorit 2014, lidhur me kërkesën e saj për rishqyrtimin e listës përfundimtare me pikët e vlerësimit të kandidatëve, të 31 majit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së procedurës së zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit, përkatësisht të Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës për emërimin dhe propozimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit (KPK nr. 151/2014, të 6 qershorit 2014), z. Shyqyri Syla, dhe Vendimin KPK/146/2014, të 5 qershorit 2014, lidhur me kërkesën e parashtrueses, znj. Laura Pula, për rishqyrtimin e listës përfundimtare të vlerësimit të kandidatit.
4. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Këshilli Prokurorial i Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK), gjatë procesit të zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit, kishte shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 7 [Vlerat] dhe nenin 24 [Barazia para Ligjit], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
5. Përveç kësaj, parashtruesi z. Shyqyri Syla, kërkesa KI99/14, kërkoi nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) të vendosë Masë të përkohshme, përkatësisht të pezullojë procedurën e emërimit të kandidatit të propozuar, në pritje të rezultatit të procedurës në Gjykatë.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56.1 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 12 qershor 2014, parashtruesit e kërkesës i dorëzuan kërkesat e tyre në mënyrë individuale në Gjykatë.

8. Më 13 qershor 2014, parashtruesi i kërkesës (KI99/14, z. Shyqyri Sylja) dorëzoi në Gjykatë kopjen e ankesës së tij, të ushtruar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative.
9. Më 17 qershor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI99/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari me Vendimin KSH. KI39/14 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.
10. Më 17 qershor 2014, në pajtim me rregullin 37.1 të Rregullores së punës, Kryetari urdhëroi bashkimin e kërkesës KI100/14 me kërkesën KI99/14. Me këtë urdhër, u vendos që gjyqtari raportues dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues të mbeten të njëjtë sikur ishte caktuar me vendimet (GJR. KI99/14 dhe KSH. KI99/14) e Kryetarit për caktimin e gjyqtarit raportues dhe të Kolegjit shqyrtues, më 17 qershor 2014.
11. Më 19 qershor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës lidhur me regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave. Të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi dhe i dërgoi KPK-së kopjet e kërkesave.
12. Më 19 qershor 2014, parashtruesja e kërkesës (KI100/14, znj. Laura Pula) dorëzoi në Gjykatë informata shtesë dhe argumente.
13. Më 24 qershor 2014, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Presidentit të Republikës së Kosovës.
14. Më 24 qershor 2014, KPK-ja dorëzoi në Gjykatë dokumentet lidhur me procesin e përzgjedhjes.
15. Më 26 qershor 2013, gjyqtari Kadri Kryeziu njoftoi me shkrim Gjykatën për mospjesëmarrjen e tij në seancat e këshillimeve për periudhën qershor-korrik 2014, duke pritur vendimin e Gjykatës përkitazi me pretendimet e ngritura ndaj tij.
16. Më 3 korrik 2014, Gjykata vendosi të miratojë kërkesën për Masë të përkohshme.
17. Të njëjtën ditë, Gjykata mbajti këshillimet dhe votoi për rastin.

Përmbledhja e fakteve

18. Më 27 mars 2014, KPK-ja publikoi shpallje të brendshme për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit.
19. Më 11 prill 2014, KPK-ja nxori Vendimin KPK nr. 90/2014 për caktimin e Panelit të KPK-së për shqyrtimin preliminar. Të njëjtën ditë, KPK-ja nxori vendimin KPK nr. 91/2014 për caktimin e Komisionit të KPK-së për rikonsiderim.
20. Më 17 prill 2014, Paneli i KPK-së për shqyrtim preliminar, pas shqyrtimit të kërkesave dhe të dokumenteve të dorëzuara nga nëntë (9) kandidatë, vendosi që

vetëm gjashtë (6) kandidatë i kishin përmbushur kriteret për postin e Kryeprokurorit të Shtetit, siç parashihet me ligjin në fuqi.

21. Më 25 prill 2014, Komisioni për rikonsiderim, pas shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga dy (2) kandidatë që nuk ishin përzgjedhur gjatë procesit të shqyrtimit preliminar, vendosi t'i miratojë kërkesat e tyre dhe të shpallë listën prej tetë (8) kandidatëve të kualifikueshëm për procedurat e mëtejshme të përzgjedhjes.
22. Nga 29 deri më 31 maj 2014, u mbajt procesi i intervistimit të këtyre tetë (8) kandidatëve.
23. Më 31 maj 2014, KPK-ja publikoi listën me rezultatet përfundimtare të vlerësimit për secilin kandidat. Në pajtim me dispozitat e Rregullores për kriteret dhe për procedurën e nominimit dhe të propozimit për emërim të Kryeprokurorit të Shtetit (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja), tre kandidatët më të suksesshëm ishin kualifikuar për procedurën e votimit të fshehtë.
24. Parashtruesi i kërkesës (z. Shyqyri Syla, KI99/14) ishte ndër tre kandidatët e parë, ndërsa parashtruesja e kërkesës (znj. Laura Pula, KI100/14) ishte renditur e pesta dhe, për këtë arsye, nuk i nënshtrohej procedurës së mëtejshme të përzgjedhjes.
25. Parashtruesja e kërkesës (znj. Laura Pula, KI100/14) paraqiti kërkesë për rishqyrtim në KPK.
26. Në kërkesën e saj për rishqyrtim, parashtruesja e kërkesës (znj. Laura Pula, KI100/14), pretendonte se janë shkelur procedurat në aspektin e dhënies së pikëve të kandidatëve. Parashtruesja e kërkesës ka theksuar se, për konceptdokumentin e dorëzuar, njëri prej anëtarëve i kishte dhënë pesë (5) pikë, ndërsa, duke iu referuar tabelës së pikëve të vlerësimit, e cila është pjesë përbërëse e Rregullores, kërkohej të jepeshin jo më pak se dhjetë (10) pikë.
27. Më 5 qershor 2014, KPK-ja me vendimin KPK/146/2014, e refuzoi si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga parashtruesja e kërkesës (znj. Laura Pula, KI100/14).
28. KPK-ja, në vendimin e tij për refuzimin e kërkesës së parashtrueses për rishqyrtim, kishte konstatuar si në vijim:

“KPK konstatoi se tabela në faqen 30 të Rregullores edhe pse është pjesë integrale e Rregullores e njëjta ka shërbyer vetëm si tabelë orientuese gjatë vlerësimit dhe jo kornizë determinuese për caktimin e mënyrës së poentimit nga secili anëtar i KPK-së”.
29. Më 6 qershor 2014, Paneli i KPK-së, i përbërë nga 7 (shtatë) anëtarë, mbajti procedurën e fshehtë të votimit dhe, me 4 (katër) vota, zgjodhi kandidatin në postin e Kryeprokurorit të Shtetit. Parashtruesi i kërkesës (z. Shyqyri Syla,

KI99/14) mori 3 (tri) vota dhe, në këtë mënyrë, nuk u zgjodh kandidat për Kryeprokuror të Shtetit.

30. Një nga 7 (shtatë) anëtarët e KPK-së, që votuan për kandidatin për Kryeprokuror të Shtetit, ishte gjithashtu një kandidat në procedurën e zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit. Ky anëtar është zgjedhur si një kandidat në listën përfundimtare prej tetë (8) kandidatëve, të 25 prillit 2014, por nuk ishte zgjedhur si kandidat në listën përfundimtare prej 3 (tre) kandidatëve të renditur në pozitën më të lartë të 31 majit 2014, që i ishin nënshtruar votimit të fshehtë nga ana e Panelit të KPK-së. Bazuar në dosjen e procedurës përzgjedhëse, të paraqitur nga KPK-ja, duket se ky kandidat, i cili është anëtar i KPK-së, nuk ishte anëtar i Panelit për shqyrtimin preliminar të KPK-së dhe të Komisionit për rikonsiderim të KPK-së.
31. Të njëjtën ditë, KPK-ja nxori vendimin KPK nr. 151/2014 për nominimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit.
32. Më 12 qershor 2014, KPK-ja i dërgoi Presidentit të Republikës së Kosovës propozimin për emërimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit.
33. Më 13 qershor 2014, kundër vendimit KPK nr. 151/2014 për nominimin dhe për propozimin e kandidatit në postin e Kryeprokurorit të Shtetit, të 6 qershorit 2014, parashtruesi i kërkesës (z. Shyqyri Sylja, KI99/14) paraqiti padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative.
34. Deri më sot, Presidenti i Republikës së Kosovës, nuk nxori ndonjë dekret për emërimin e kandidatit të propozuar të KPK-së për postin e Kryeprokurorit të Shtetit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

35. Siç u tha më lart, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Këshilli Prokurorial i Kosovës, gjatë procesit të zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit, kishte shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht me nenin 3 [Barazia para Ligjit], me nenin 7 [Vlerat] dhe me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.

1. Pretendimet e parashtruesit të kërkesës (z. Shyqyri Sylja, KI99/14)

36. Parashtruesi i kërkesës pretendon si në vijim:

“Më 06.06.2014, është mbajtur mbledhja e Këshillit Prokurorial të Kosovës, ku është votuar për kandidatin për Kryeprokuror të Shtetit. Në këtë mbledhje ka marrë pjesë dhe votuar edhe kandidati [...] për Kryeprokuror të Shtetit, por nuk ka hyrë në garë në treshen e parë.

Konsideroj se votimi i këtij kandidati ka pasur konflikt interesi, pastaj ka pasur arbitraritet, meqenëse nuk ka marrë pjesë në vlerësimin e dokumentacionit të

kandidatëve, e as në intervistimin e tyre, dhe pa pasur njohuri fare, vetëm ka hudhur votën e tij, duke vënë kandidatët në pozitë të pabarabartë”.

37. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata:

“Anulimin e procesit zgjedhor dhe aplikimin e masës së përkohshme për ndalimin e dekretimit”.

2. Pretendimet e parashtrueses së kërkesës (znj. Laura Pula, KI100/14)

38. Parashtruesja e kërkesës pretendon se KPK-ja nuk ka vepruar në pajtim me Rregulloren për kriteret dhe për procedurat për propozimin dhe emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).
39. Në këtë drejtim, ajo konstaton si në vijim: *“Prandaj këtu shtrohet pyetja e parimit së sigurisë juridike sepse kandidatët nuk kanë pritur që poentimi mund të ndryshojë prej asaj çka është përcaktuar me Rregulloren për kriteret dhe procedurën e nominimit dhe propozimit për emërim të Kryeprokurorit të shtetit”.*
40. Lidhur me pretendimet e saj për shkeljen e të drejtave të saj kushtetuese, të garantuara me nenet 3, 7 dhe 24 të Kushtetutës, parashtruesja gjithashtu i referohet dispozitave të Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe thekson si në vijim:

“Se nuk është respektuar barazia gjinore konstatohet se ndër të gjithë 8 (tetë) kandidatët për kryeprokuror vetëm unë jam kandidate femër. Sipas konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, parashihet se diskriminimi ndaj grave shkel parimet e barazisë së të drejtave dhe të respektimit të dinjitetit njerëzor pengon pjesëmarrjen e grave në të njëjtat kushte me burrat në jetën politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore, pengon ngritjen e mirëqenies së shoqërisë dhe të familjes dhe vështirëson më tepër zhvillimin e potencialeve të grave në shërbimin të atdheut të tyre dhe njerëzimit.

Sipas nenit 2 pika "q" të kësaj konvente thuhet se: dënohet diskriminimi ndaj grave në të gjitha format dhe se shtetet nuk duhet të ndër marrin asnjë veprim ose praktikë diskriminuese ndaj grave dhe të sigurojnë që autoritet dhe institucionet publike të veprojnë në përputhje me këtë detyrim.

Bazuar në këtë konsiderojmë se është shkelur edhe neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës-Deklarata universale për të drejtat e njeriut pika 6-konkretisht konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të gruas”.

41. Sa i përket shterimit të mjeteve juridike, parashtruesja e kërkesës pretendon si në vijim:

“Për më tepër ligji për KPK-në nuk parasheh ndonjë dispozitë ligjore lidhur me ankesat kundër vendimit të KPK-së. Duhet theksuar se mungesa e mjetit juridik për të apeluar vendimet e KPK -së në shkallë të dytë është konstatuar edhe nga mekanizmat ndërkombëtarë në Kosovë, dhe krijimi i mundësisë së apelit është edhe rekomandim i Komisionit të Venecias për Kosovën, të cilët kanë sugjeruar që një gjë e tillë të përfshihet gjatë plotësimit dhe ndryshimit të ligjit për KPK-në dhe KGJK-në”.

Dispozitat ligjore relevante lidhur me emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit

I. Neni 109 [Prokurori i Shtetit], paragrafi 7 i Kushtetutës

Kryeprokurori i Shtetit emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, në bazë të propozimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Mandati i Kryeprokurorit të Shtetit është shtatëvjeçarë, pa mundësi riemërimi.

II. Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës Nr. 03/l-224

Neni 5 [Përbërja dhe Përzgjedhja e Anëtarëve të Këshillit]

1. Këshilli përbëhet nga nëntë (9) anëtarë të cilët janë shtetas të Republikës së Kosovës, pesë (5) nga të cilët janë prokurorë.

2. Nga pesë (5) prokurorët që shërbejnë si anëtarë të Këshillit përfshihen:

2.1. Kryeprokurori i Shtetit;

2.2. një (1) prokuror nga Prokuroria Speciale që zgjidhet nga prokurorët që shërbejnë në atë zyrë;

2.3. një (1) prokuror nga Prokuroria e Apelit që zgjidhet nga prokurorët që shërbejnë në atë zyrë, dhe

2.4. dy (2) prokurorë nga Prokuroria Themelore që zgjidhen nga prokurorët që shërbejnë në atë zyrë.

3. Anëtarët jo-prokurorë të Këshillit emërohen nga Këshilli bazuar në një listë prej së paku pesë (5) kandidatësh për secilën pozitë të dërguar nga organet relevante dhe kjo përfshin:

3.1. një (1) anëtar nga Oda e Avokatëve të Kosovës i cili ka specializuar në të drejtën penale, me anë të propozimit të Këshillit Ekzekutiv të Odës së Avokatëve;

3.2. një (1) profesor nga fakultetet juridike të Republikës së Kosovës sipas propozimit të Departamentit për Arsimit të Lartë apo të autoritetit relevant që lidhet me arsimin e lartë;

3.3. një (1) përfaqësues nga shoqëria civile me përgatitje të lartë profesionale dhe me njohuri nga fusha e të drejtave të njeriut.

[...]

Neni 20 [Emërimi i Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve]

1. Këshilli bën nominimin e Kryeprokurorit të Shtetit nga radhët e Prokurorëve dhe ai emërohet nga Presidenti për një mandat shtatë (7) vjeçare, pa mundësi riemërimi.

2. Këshilli emëron Kryeprokurorët për të gjitha njësitë e tjera të Prokurorit të Shtetit. Çdo prokuror i cili është subjekt i kualifikimeve të përcaktuara me Ligjin mbi Prokurorët e Shtetit ka të drejtë të propozohet për postin e Kryeprokurorit.

3. Kryeprokurori emërohet nga Këshilli për një periudhë katër (4) vjeçare, me mundësi vazhdimi edhe për një mandat shtesë.

4. Në mënyrë që të sigurohet se Prokurori i Shtetit pasqyron natyrën shumetnike të Kosovës, Këshilli përpiket të sigurojë që anëtarët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë të emërohen në role menaxhuese.

5. Nëse një kandidat i propozuar për Kryeprokuror është anëtar i Këshillit, ai apo ajo nuk mund të merr pjesë në shqyrtime apo votimin për emërimin e Kryeprokurorit.

6. Këshilli autorizohet të largojë një Kryeprokuror nga ajo pozitë, në pajtim me vlerësimet e performansës të ndërmarra në përputhje me ligjin e zbatueshëm, ose me rastin e konstatimit të sjelljes kriminale, keq-menaxhimit, jo-kompetencës, apo dështimit në kryerjen e detyrave të pozitës.

[...]

III. Rregullorja për kriteret dhe për procedurën e nominimit dhe të propozimit për emërim të Kryeprokurorit të Shtetit

Neni 9 [Paneli i KPK-së për Shqyrtimin Preliminar]

1. KPK-ja do të themelojë Panelin për Shqyrtimin Preliminar të aplikacioneve për Kryeprokuror të shtetit, në këtë përbërje:

1.1 Një anëtar i KPK-së; kryetar;

1.2 Një prokuror nga Prokuroria e Apelit, i cili nuk ka aplikuar për KPSH; dhe

- 1.3 Një prokuror nga PSRK-ja, i cili nuk ka aplikuar për KPSH.
2. Paneli ka kompetencë dhe përgjegjësi vetëm për shqyrtimin e aplikacioneve për KPSH, nëse të njëjtat plotësojnë kriteret e parapara me nenin 3 paragrafi 1,2,3 dhe 4 dhe neni 4 të kësaj rregulloreje.
3. Paneli brenda 7 ditëve shqyrton aplikacionet dhe përpilon listën e kandidatëve të cilët plotësojnë kriteret për KPSH.
4. Kandidatët të cilët nuk i kanë plotësuar kriteret për KPSH do të njoftohen me shkrim. Njoftimi duhet të përfshijë edhe informatën për të drejtën e kandidatit për të parashtruar kërkesë për ri-konsiderim tek Komisioni për ri-konsiderim në afat prej 5 ditëve nga dita e pranimit të njoftimit.
5. Kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret për KPSH do të njoftohen me shkrim.
6. Njoftimi i lidhur me paragrafin 4 dhe 5 të këtij neni do të publikohet në dy gjuhët zyrtare në ueb faqen e PSH-së dhe KPK-së. Kandidatët do të njoftohen përmes email-it zyrtar dhe mesazhit telefonik. Konfirmimi për pranimin e njoftimit është i obligueshëm nga të gjithë kandidatët për KPSH.

Neni 10 [Komisioni për ri-konsiderim]

1. KPK-ja themelon Komisionin për ri-konsiderim, me kompetencë dhe përgjegjësi për shqyrtimin e kërkesave për ri-konsiderim ndaj vendimeve të panelit të KPK-së për shqyrtim preliminar të aplikacioneve të kandidatëve për KPSH.
2. Komisioni për ri-konsiderim është në këtë përbërje:
 - 2.1 Kryeprokurori i Shtetit, kryetar;
 - 2.2 Një prokuror nga PA i cili nuk ka aplikuar për KPSH; dhe
 - 2.3 Një prokuror nga PSRK i cili nuk ka aplikuar për KPSH.
3. Komisioni brenda 5 ditëve nga dita e skadimit të afatit për pranim të kërkesave për ri-konsiderim do të marrë vendim për çdo kërkesë të pranuar.
4. Lidhur me vendimin e Komisionit, do të informohen kandidatët të cilët kanë paraqitur kërkesë për ri-konsiderim, si dhe anëtarët e KPK-së.
5. Vendimet e Komisionit publikohen në ueb faqe të KPK-së dhe PSH-së më së voni 24 orë pas marrjes së vendimit.

Neni 12 [Komisioni për vlerësim, intervistim dhe votim]

1. Anëtarët e KPK-së, të cilët nuk përjashtohen sipas paragrafit 5 të nenit 20 të ligjit për KPK-në, e përbëjnë komisionin për vlerësim, intervistim dhe votim për KPSH..

Neni 13 [Vlerësimi i kandidatëve për Kryeprokuror të Shtetit]

1. Vlerësimi i kandidatëve për Kryeprokuror të Shtetit do të përfshijë: Integritetin personal, profesional dhe moral, i cili bazohet në:

1.1 Vlerësimin e performancës për tri vitet e fundit;

1.2 Informatat e pranuar nga AKK,

1.3 Informatat e pranuar nga NJIF;

1.4 Informatat e pranuar nga AKI;

1.5. Të dhënat lidhur me masat eventuale disiplinore ndaj kandidatëve dhe informacionet nga ZPD-ja nëse ndaj ndonjë kandidati janë duke u zhvilluar hetime disiplinore.

1. Obligohet Kryeprokurori i shtetit që të kërkojë informatat nga paragrafi 1, pikat 1.2; 1.3; 1.4 dhe 1.5 të këtij neni, për të gjithë kandidatët që kanë aplikuar për KPSH. Këto informata vendosen në dosjen e kandidatit dhe në to kanë qasje anëtarët e KPK-së.

2. Informatat nga paragrafi 1, pika 1.2; 1.3; 1.4 dhe 1.5 të këtij neni, për kandidatët të cilët eliminohen nga Paneli dhe Komisioni për ri-konsiderim i dorëzohen Kryeprokurorit të ardhshëm.

Neni 16 [Poentimi i kandidatëve]

1. Poentimi i kandidatëve bëhet në formulët me numër 2 dhe 3.

2. Çdo anëtar i KPK-së i poenton kandidatët sipas formularëve 2 dhe 3;

3. Poenat e të gjithë anëtarëve të KPK-së mblidhen në një formular të vetëm për çdo kandidat.

4. Pas poentimit të kandidatëve, KPK-ja bën renditjen e kandidatëve sipas poenave të fituara gjatë procesit të vlerësimit dhe intervistimit, duke renditur tre kandidatët më së shumti poena.

5. Çdo anëtar i KPK-së, mund t'a poentojë një kandidat me më së shumti 100 (njëqind) poena, si në vazhdim:

5.1 Për dokumentin e vetë-vlerësimit një kandidat mund të poentohet me më së shumti 20 (njëzet) poena;

5.2 Për koncept dokumentin një kandidat mund të poentohet me më së shumti 30 (tridhjetë) poena;

5.3 Për intervistën me gojë një kandidat mund të poentohet me më së shumti 20 (njëzet) poena;

5.4 Për integritetin një kandidat mund të poentohet me më së shumti 30 (tridhjetë) poena.

6. Tre (3) kandidatët me më së shumti poena, do t'i nënshtrohen procesit të votimit të fshehtë nga anëtarët e KPK-së.

7. Kandidati i cili nuk hynë në listën e tre (3) kandidatëve për votim në KPK, brenda tre (3) ditëve pas njoftimit, mund të kërkoj nga KPK-ja të rikonsiderojë kërkesën e tij vetëm mbi bazën nëse konsideron se ka pasur shkelje procedurale në zbatimin e kësaj rregulloreje.

8. Njoftimi nga paragrafi 7, i këtij neni bëhet me shkrim dhe i bashkëngjitet një kopje e poentimit të përgjithshëm të kandidatit..

9. Kandidatët të cilët nuk janë renditur ndër tre (3) të parët me më së shumti poena, kanë të drejtë të kenë qasje në dokumentin e vlerësimit të tij për të verifikuar poentimin. Mirëpo, kandidati nuk ka të drejtë qasje në identitetin e anëtarit të KPK-së i cili ka bërë vlerësimin dhe poentimin individual.

10. KPK-ja në afat prej shtatë (7) ditësh pas pranimit të kërkesës së kandidatit për të verifikuar poentimin, do të vendosë nëse kërkesa pranohet apo refuzohet dhe njofton me shkrim kandidatin për marrjen e vendimit.

Neni 17 [Procesi i votimit për kryeprokuror të shtetit]

1. Tre (3) kandidatët e parë, të cilët marrin më së shumti poena, do të hyjnë në procesin e votimit të fshehtë.

2. Votimi i tre (3) kandidatëve të parë të renditur sipas poenave bëhet me vota të fshehta nga anëtarët e KPK-së, duke përjashtuar anëtarin e KPK-së nëse ai është njëri prej tre kandidatëve për të cilin do të votohet.

3. Nëse votimi i fshehtë rezulton me barazim, votimi i fshehtë do të përsëritet vetëm për kandidatët që kanë marrë vota të barabarta, deri në votimin në të cilin një kandidat merr votat e nevojshme për KPSH.

4. Kandidati i cili në votimin e fshehtë fiton më së shumti vota nga anëtarët e KPK-së do të propozohet për emërim për kryeprokuror të shtetit tek Presidenti i Republikës së Kosovës.

5. Propozimi për emërim nënshkruhet nga Kryetari i KPK-së. Propozimi për emërim duhet të jetë i arsyetuar me shkrim, duke përfshirë gjithë procesin e nominimit të kandidatit të propozuar për emërim për Kryeprokuror të shtetit.

6. Propozimi për emërim të kandidatit për KPSH nga KPK-ja, i dërgohet

Presidentit të shtetit, jo më vonë se pesë (5) ditë nga dita e marrjes së vendimit..

7. Mbledhja dhe votimi i fshehtë i KPK-së, mbahet i hapur për publikun, por KPK-ja mund të votojë për të mbyllur pjesën e mbledhjes gjatë të cilës diskutohen meritat e kandidatëve për KPSH.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

42. Para së gjithash, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesve të kërkesës, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

43. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113, paragrafi 7, të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

44. Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës janë palë të autorizuar, në pajtim me nenin 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës.

45. Gjykata i referohet edhe neneve 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

“48. Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

49. Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.

46. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

a) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar;

b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesit; ose

c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar”.

47. Siç u theksua më lart, parashtruesit e kërkesës e kontestojnë procedurën e zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit. Në këtë drejtim, parashtruesja e kërkesës (znj. Laura Pula, KI100/14) në mënyrë specifike e konteston Vendimin KPK nr. 146/2014 të Komisionit të KPK-së për rikonsiderim (KPK nr. 146/2014, e 5 qershorit 2014), ndërsa parashtruesi (z. Shyqyri Syla, KI99/14) e konteston Vendimin e KPK-së, KPK nr. 151/2014, e 6 qershorit 2014, për nominimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit.
48. Gjykata vëren se dispozitat e ligjit në fuqi, Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nuk parashikojnë asnjë mjet juridik kundër vendimeve të kontestuara nga parashtruesit e kërkesës.
49. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës janë të obliguar t'i shterin “ [...] mjetet juridike që janë të qasshme, për të siguruar kompensim lidhur me ankesat e tyre dhe që ofrojnë mundësi të arsyeshme për sukses. Baza e mjetit juridik në të drejtën vendore duhet të jetë e qartë” (Shih rastin *Scavuzzo-Hager dhe të tjerët kundër Zvicrës*, Kërkesa nr. 41773/98, GJEDNJ, 7 shkurt 2006).
50. Megjithatë, Gjykata vëren se, edhe në qoftë se ka mjete juridike, në rastin e parashtruesit nuk janë dëshmuar si efikase. Për më tepër, duke marrë parasysh specificitetin e procedurës së zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe domosdoshmërinë që kjo të bëhet në kohën e duhur, Gjykata është e mendimit që nuk ka mjete juridike për shterim.
51. Në këtë drejtim, duke iu referuar rasteve të gjykuara nga Gjykata në lidhje me procedurën e emërimit dhe të riemërimit të prokurorëve, në mënyrë të veçantë duke iu referuar rastit nr. KI114/10 *Vahide Badivuku*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 majit 2011, Gjykata konsideron se, në bazë të rrethanave të çështjes dhe të procedurave të përfunduara, kjo kërkesë ndryshon nga rasti i lartpërmendur për arsyt vijuese:
52. Së pari, para hyrjes në fuqi të Ligjit për Gjykatat, Nr. 03/L-199, procedura për konflikte administrative kundër akteve administrative përfundimtare është iniciuar në Gjykatën Supreme. Me hyrjen në fuqi të Ligjit të lartpërmendur për Gjykatat (1 janar 2013), procedura e konfliktit administrativ rregullohet si më poshtë:

Neni 14 [Departamenti për çështje Administrative i Gjykatës Themelore]

“1. Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore gjykon dhe vendos në konfliktet administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe për çështjet e tjera të përcaktuara me ligj.

2. Të gjitha çështjet në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore gjykohen nga një (1) gjyqtar profesionist, përpos nëse me ligj nuk parashihet ndryshe”.

53. Së dyti, Gjykata vëren se ekziston vetëm një pozitë për Kryeprokuror të Shtetit, si, për shembull, në krahasim me pozitat e shumta për emërimin dhe për riemërimin

e gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Kështu, Gjykata është e vetëdijshme se ka pranuar disa aplikacione prej gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët nuk janë riemëruar. Rasti i tanishëm, megjithatë, është faktikisht ndryshe. Së pari, për shkak se në ato raste të tjera ka pasur pozita të shumta dhe gjykatat e rregullta mund të kenë korigjuar aplikacionet, në qoftë se shkelja është dëshmuar muaj më vonë. Së dyti, në rastin konkret, nuk duket se ka kohë të mjaftueshme për ndonjë gjykatë tjetër ta adresojë këtë mjet juridik para emërimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

54. Gjykata kështu konstaton se parashtruesit nuk kanë në dispozicion mjete juridike për të shteruar para se të vazhdojnë me pretendimet e tyre për shkelje kushtetuese.
55. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu konstaton se parashtruesit kishin dorëzuar kërkesat e tyre në Gjykatë brenda afatit kohor prej 4 (katër) muajsh.
56. Më tej, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kanë treguar se cilat të drejta kushtetuese u janë shkelur dhe ata i kontestojnë vendimet konkrete (KPK nr. 146/2014, të 5 qershorit 2014, dhe KPK nr. 151/2014, të 6 qershorit 2014).
57. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesat janë të pranueshme.

Meritat e rastit

58. Parashtruesit e kërkesës kryesisht pretendojnë se vendimet e kontestuara, të nxjerra gjatë procedurës së zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit, kishin shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], me nenin 7 [Vlerat] dhe me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.
59. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet dispozitave të lartpërmendura të Kushtetutës:

Neni 3 [Barazia para Ligjit]

1. Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.

2. Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

Neni 7 [Vlerat]

1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit,

drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

2. Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

60. Sa i përket të drejtave që kërkohen nga parashtruesit e kërkesës, Gjykata rikujton se *"është mjeshtëri i karakterizimit që duhet dhënë në ligj për faktet e rastit dhe nuk është i lidhur me karakterizimin e dhënë nga parashtruesi i kërkesës ose një qeveri. Ankesa karakterizohet nga faktet e pretenduara në të dhe jo thjesht nga bazat ligjore apo argumentet në të cilat mbështetet"*. (Shih *mutatis mutandis* Rasti *Ştefănică dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Kërkesa nr. 38155/02, ECHR, Aktgjykimi i 2 nëntorit 2010, par. 23).

61. Prandaj, Gjykata do të analizojë ankesat e parashtruesve bazuar në faktet e pretenduara dhe në provat e bashkangjitura në to, lidhur me pretendimet e tyre të shkeljes së të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

62. Në këtë drejtim, Gjykata do të vlerësojë zbatueshmërinë e kritereve të përcaktuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe me nenin 6 [E Drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së, në lidhje me procedurën e zgjedhjes të kryer nga KPK-ja.

63. Neni 31 i Kushtetutës përcakton:

"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që

ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.

64. Përveç kësaj, nenin 6.1 i KEDNJ-së përcakton:

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile”.

65. Gjykata i referohet nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

66. Gjykata vëren se, në rastin e parashtrueses së kërkesës (znj. Laura Pula, KI100/14), Vendimi për refuzimin e kërkesës së saj për rikonsiderim (KPK/146/2014, i 5 qershorit 2014) është nxjerrë nga Komisioni për rikonsiderim, i themeluar nga KPK-ja në bazë të dispozitave të mësipërme juridike në fuqi. Vendimi për nominimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit (KPK nr. 151/2014, i 6 qershorit 2014) është nxjerrë nga 7 (shtatë) anëtarë të KPK-së, pas një votimi të fshehtë.

67. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se KPK-ja, si organ i themeluar me Kushtetutë, gjatë procedurës së zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit, duhet të jetë në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 31 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së.

68. Rrjedhimisht, Gjykata do t'i shqyrtojë meritat e secilit pretendim të parashtruesve të kërkesës.

1. Meritat e rastit të parashtruesit të kërkesës z. Shyqyri Syla, Kërkesa KI99/14

69. Duke iu referuar procedurës së zgjedhjes në rastin e parashtruesit, Gjykata rikujton se parashtruesi ishte ndër tre kandidatët më të suksesshëm, të cilët ishin të kualifikueshëm për të hyrë në procedurë të mëtejshme të përzgjedhjes, përkatësisht në procedurë të votimit të fshehtë të KPK-së.

70. Si pasojë, më 6 qershor 2014, KPK-ja, e përbërë nga 7 (shtatë) anëtarë, zhvilloi procedurën e fshehtë të votimit, me ç'rast kandidati për postin e Kryeprokurorit të Shtetit ishte zgjedhur me 4 (katër) vota nga 7 (shtatë). Parashtruesi i kërkesës kishte marrë 3 (tri) vota dhe, në këtë mënyrë, nuk ishte zgjedhur kandidat për Kryeprokuror të Shtetit.

71. Gjykata më tej përkujton se 1 (një) nga 7 (shtatë) anëtarët e KPK-së, që votuan për kandidatin për Kryeprokuror të Shtetit, ishte gjithashtu kandidat në procedurën e zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit. Ky anëtar, si kandidat, është përzgjedhur në listën përfundimtare prej 8 (tetë) kandidatëve të 25 prillit 2014, por nuk ishte përzgjedhur në listën përfundimtare prej 3 (tre) kandidatëve të renditur në pozitën më të lartë, që i ishin nënshtruar votimit të fshehtë nga Paneli i KPK-së.
72. Bazuar në faktet e mësipërme, parashtuesi i kërkesës e konteston Vendimin e KPK-së për emërimin e kandidatit për postin e Kryeprokurorit të Shtetit (KPK nr. 151/2014, e 6 qershorit 2014), dhe pretendon:
- “Konsideroj se votimi i këtij kandidati ka pasur konflikt interesi, pastaj ka pasur arbitraritet, meqenëse nuk ka marrë pjesë në vlerësimin e dokumentacionit të kandidatëve, e as në intervistimin e tyre, dhe pa pasur njohuri fare, vetëm ka hudhur votën e tij, duke vënë kandidatët në pozitë të pabarabartë”.*
73. Gjykata konsideron se KPK-ja, gjatë procedurës së zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit, është dashur të përmbushë parimet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 6 të KEDNJ-së dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në mënyrë që të sigurojë procedurë të zgjedhjes transparente, të drejtë dhe objektive, të bazuar në barazi.
74. Përkitazi me atë nëse KPK-ja kishte përmbushur garancinë procedurale, duke përfshirë shfaqjen e “paanshmërisë”, Gjykata më tutje i referohet praktikës gjyqësore të vendosur të GJEDNJ-së. Në rastin *Wettstein*, KEDNJ-ja konstatoi se ekzistenca e paanshmërisë për qëllimet e nenit 6, paragrafi 1, duhet të përcaktohet në bazë të: *“(i) një testi subjektiv, ku duhet të ketë kujdes për bindjen personale dhe sjelljen e një gjyqtari të caktuar - përkatësisht, nëse gjyqtari kishte ndonjë paragjykim personal ose anshmëri në një çështje të caktuar; dhe (ii) një testi objektiv, që do të thotë duke vërtetuar nëse gjykata vetë dhe, në mesin e aspekteve të tjera, përbërja e tij, ofroi garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në lidhje me paanshmërinë e saj”* (Shih, *mutatis mutandis*, ndër autoritete të tjera, rasti *Wettstein kundër Zvicrës*, Kërkesa Nr. 33958/96, ECHR, par. 42).
75. Në këtë drejtim dhe në mënyrë të veçantë duke iu referuar rëndësisë dhe natyrës së pozitës së Kryeprokurorit të Shtetit, Gjykata vëren se edhe shfaqjet e paanshmërisë mund të jenë të një rëndësie të veçantë (Shih, *mutatis mutandis*, rasti *De Cubber kundër Belgjikës*, Kërkesa nr. 9186/80, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 tetorit 1984, par. 26). Çështje e rëndësishme këtu është besimi, të cilin një autoritet publik, në një shoqëri demokratike, siç është KPK-ja, gjatë procesit të zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit, duhet ta bartë në publik, si dhe besimi i publikut në personin e zgjedhur si Kryeprokuror të Shtetit.
76. Sipas mendimit të Gjykatës, këto rrethana shërbejnë në mënyrë objektive për të arsyetuar frikën e parashtuesit se, KPK-së, gjatë procedurave të votimit për

kandidatin për Kryeprokuror të Shtetit, duke përfshirë një anëtar i cili ishte gjithashtu kandidat për postin e Kryeprokurorit të Shtetit, i kishte munguar shfaqja e paanësisë së nevojshme. Kështu, Gjykata konsideron se anëtari që ishte kandidat për postin e Kryeprokurorit të Shtetit duhej të ishte përjashtuar nga procedurat e votimit dhe të nominimit dhe duhej të ishte zëvendësuar me një anëtar tjetër.

77. Në bazë të asaj që u tha më sipër, Gjykata konstaton se, në këtë rast, ka pasur shkelje të së drejtës për procedurë të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së.
78. Për më tepër, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme të merret më tej me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të neneve 3, 7 dhe 24 të Kushtetutës, posaçërisht pasi ajo ka gjetur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së.

1. Meritat e rastit të parashtrueses znj. Laura Pula, Kërkesa KI100/14

79. Gjykata vëren se, në bazë të listës së 31 majit 2014, me rezultatet përfundimtare të vlerësimit për secilin kandidat të publikuar nga KPK-ja, parashtruesja e kërkesës ishte renditur e pesta dhe për këtë arsye nuk i ishte nënshtruar procedurave të votimit dhe të nominimit. Pas publikimit të kësaj liste, parashtruesja e kërkesës paraqiti kërkesë për rishqyrtim në KPK.
80. Në kërkesën e saj për rishqyrtim, parashtruesja pretendonte se njëri nga anëtarët e Panelit i kishte dhënë 5 (pesë) pikë për konceptdokumentin që ajo kishte dorëzuar, ndërsa duke iu referuar tabelës së pikëve të vlerësimit, e cila është pjesë përbërëse e Rregullores, kërkohej që të jepeshin jo më pak se 10 (dhjetë) pikë.
81. Rrjedhimisht, më 5 qershor 2014, KPK-ja, me vendimin e saj KPK/146/2014, e refuzoi si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga parashtruesja e kërkesës, duke konstatuar si në vijim:

“KPK, konstatoi se tabela në faqen 30 të Rregullores edhe pse është pjesë integrale e Rregullores e njëjta ka shërbyer vetëm si tabelë orientuese gjatë vlerësimit dhe jo kornizë determinuese për caktimin e mënyrës së poentimit nga secili anëtar i KPK-së”.

82. Në këtë drejtim, parashtruesja pretendon si në vijim:

“Prandaj këtu shtrohet pyetja e parimit së sigurisë juridike sepse kandidatët nuk kanë pritur që poentimi mund të ndryshojë prej asaj çka është përcaktuar me Rregulloren për kriteret dhe procedurën e nominimit dhe propozimit për emërim të Kryeprokurorit të shtetit”.

83. Bazuar në këtë, parashtruesja e kërkesës pretendon shkeljen e parimit të sigurisë juridike.

84. Gjykata rikujton se ky parim është i mishëruar në mënyrë të qartë me një nga të drejtat themelore të mbuluara me Kushtetutë dhe me KEDNJ, përkatësisht e drejta për gjykim të drejtë. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parimi i sigurisë juridike është në rrezik në qoftë se detyrimet ligjore nuk respektohen plotësisht. Gjykata rikujton se ky parim gjithashtu duhet të garantohet gjatë procesit të zgjedhjes të zhvilluar nga të gjitha autoritetet publike. Prandaj, KPK-ja, gjatë procesit të përzgjedhjes dhe të emërimit, ishte e nevojshme të mbante të njëjtat standarde për secilin kandidat.
85. Gjykata vëren se KPK-ja ka pranuar që shtojca e lartpërmendur me procedurën e vlerësimit është pjesë përbërëse e Rregullores. Prandaj, Gjykata konsideron se aneksi në mënyrë të qartë përcakton metodën e vlerësimit, duke siguruar pikët minimale dhe maksimale për konceptdokumentet dhe për komponentët e tjerë të vlerësimit gjatë procedurës së zgjedhjes. Prandaj, KPK-ja, duke injoruar rregullat e veta të përcaktuara, krijon një situatë të karakterizuar me supozim të arbitraritetit.
86. Rrjedhimisht, vendimit të lartpërmendur të KPK-së, me të cilin kërkesa e parashtrueses për rishqyrtim refuzohet, i mungon edhe arsytimi i qartë. E drejta për një vendim të arsyetuar i ka rrënjët në një parim më të përgjithshëm të mishëruar në KEDNJ, që mbron një individ nga arbitrariteti. Në këtë drejtim, *"Vendimi duhet të përmbajë arsyet që janë të mjaftueshme për t'iu përgjigjur aspekteve thelbësore të argumentit faktik dhe juridik material ose procedural të palës"* (Shih, *mutatis mutandis*, rasti *Torija kundër Spanjës*, Kërkesa nr. 18390/91, GJEDNJ, Aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994, para. 30).
87. Në bazë të asaj që u tha më lart, Gjykata konstaton se ka shkelje të së drejtës për procedurë të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së.
88. Përkitazi me pretendimin e parashtrueses për shkeljen e parimit të mosdiskriminimit, Gjykata vëren se, sipas Kushtetutës, një nga vlerat sipas të cilave rendi kushtetues i Republikës së Kosovës është ndërtuar në parimin e mosdiskriminimit. Në këtë drejtim, Republika e Kosovës duhet të *"sigurojë barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat e tjera të jetës shoqërore"*.
89. Gjykata vëren se parimi i lartpërmendur, që është i mishëruar në Kushtetutë, përkatësisht në nenet 3,7 dhe 24, duhet të garantohet përgjatë tërë procedurës së zgjedhjes në institucionet e Republikës së Kosovës.
90. Përkitazi me rastin konkret, parashtruesja (znj. Laura Pula, KI100/14) ishte e vetmja parashtruese femër që dorëzoi "konceptdokumentin", si pjesë e procedurave të testimit dhe të vlerësimit. Në këtë drejtim, parashtruesja pretendon:

"Se nuk është respektuar barazia gjinore konstatohet se ndër të gjithë 8 (tetë) kandidatët për kryeprokuror vetëm unë jam candidate femër. Sipas konventës

për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, parashihet se diskriminimi ndaj grave shkel parimet e barazisë së të drejtave dhe të respektimit të dinjitetit njerëzor pengon pjesëmarrjen e grave në të njëjtat kushte me burrat në jetën politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore, pengon ngritjen e mirëqenies së shoqërisë dhe të familjes dhe vështirëson më tepër zhvillimin e potencialeve të grave në shërbimin te atdheut të tyre dhe njerëzimit.

Sipas nenit 2 pika "q" të kësaj konvente thuhet se: dënohet diskriminimi ndaj grave në të gjitha format dhe se shtetet nuk duhet të ndër marrin asnjë veprim ose praktikë diskriminuese ndaj grave dhe të sigurojnë që autoritetet dhe institucionet publike të veprojnë në përputhje me këtë detyrim.

91. Edhe pse ka shfaqje që ngrenë pyetje serioze se parashtruesja mund të ketë qenë e diskriminuar për shkak të gjinisë së saj në procedurën e testimi, Gjykata konstaton se ajo nuk ka dëshmuar që ka qenë e diskriminuar në procedurën e testimi për shkak të gjinisë. Domethënë, parimi i lartpërmendur i mosdiskriminimit nuk është shkelur.
92. Në bazë të asaj që u tha më lart, Gjykata konsideron se dështimi i KPK-së në Vendimin e tij, KPK nr. 146/2014, të 5 qershorit 2014, që të pranojë rregullat e veta të përcaktuara dhe që të sigurojë një arsyetim të qartë në lidhje me aspektet thelbësore të argumentit faktit dhe ligjor procedural, është në kundërshtim me të drejtën për një procedurë të drejtë.
93. Në këtë mënyrë, Gjykata konsideron se ka shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe me nenin 24 të Kushtetutës.

Përfundim

94. Në përfundim, Gjykata vlerëson se procedura e përzgjedhjes dhe e nominimit, e kryer nga KPK-ja, përbën shkelje të së drejtës për procedurë të drejtë dhe të paanshme, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së. Kështu, Gjykata konsideron se tërë procedura e zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit duhet të përsëritet pa paragjykuar rezultatin e asaj procedure të përsëritur.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 56 (1) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 3 korrik 2014, njëzëri,

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesat të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së;
- III. TË ANULOJË vendimet e kontestuara KPK nr. 146/2014 dhe KPK nr. 151/2014 të KPK për nominimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit;
- IV. TA URDHËROJË KPK-në që ta përsëritë procedurën e zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit, në pajtim me këtë aktgjykim, pa paragjykuar rezultatin e asaj procedure të përsëritur;
- V. TA URDHËROJË KPK-në që, në pajtim me rregullin 63 (5) të Rregullores së punës, të dorëzojë në Gjykatën Kushtetuese informata për masat e ndërmarra për zbatimin e këtij aktgjykimi;
- VI. T'UA KOMUNIKOJË këtë vendim palëve;
- VII. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- VIII. Ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Robert Carolan



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani